

22 korrik 2015, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA Komunat e mëdha me sfida të shumta në qeverisje

Në kuadër të projektit “Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale”, EC Ma Ndryshe ka shqyrtuar të gjeturat e Raporteve të Auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunave Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë, Ferizaj dhe Gjilan të vitit 2014.

Të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) për vitin 2014 kanë konstatuar se komunat e mëdha të Kosovës përballen me sfida serioze në qeverisje. Auditori ka vlerësuar se aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes kërkojnë forcim, meqë ka dobësi në menaxhimin e sistemeve kryesore.

Në bazë të këtyre raporteve del se pothuajse në të gjitha komunat e lartpërmendura kontrollet mbi procesin e planifikimit, arkëtimit dhe raportimit të të hyrave nuk janë analizuar në mënyrë të qëndrueshme, me ç’rast tatimi në pronë, lejet e ndërtimit dhe të hyrat nga qiradhënia apo shfrytëzimi i pronës komunale paraqiten si zërat më problematikë.

Në të njëjtën kohë është theksuar se edhe kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalohet mundësia që komunat të kenë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv të projekteve. Dobësitë në këtë drejtim janë hasur kryesisht në fushën e prokurimit dhe kontrollin efektiv për të siguruar realizim cilësor të punëve.

Një tjetër shqetësim që konfirmohet nga Raportet e Auditimit është edhe niveli i lartë i llogarive të arkëtueshme (borxheve të paarkëtuara), që janë grumbulluar përgjatë vitesh, kryesisht nga tatimi në pronë, taksat komunale, qiraja e pronës komunale, lejet ndërtimore, etj. Rritja e vazhdueshme e këtyre llogarive sipas Auditorit ka ndodhur për shkak se komunat nuk kanë arritur të vendosin mekanizma efektiv për inkasimin e tyre dhe as që kanë përpiluar ndonjë strategji mbi veprimet që duhet të ndërmerren për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme.

Ndërkohë edhe borxhet e papaguara nga ana e komunave sipas Auditorit reflektojnë një menaxhim jo të duhur të aktiviteteve buxhetore, meqë është hyrë në obligime përkundër faktit se ekzekutimi i buxhetit nuk është në shkallën qind për qind.

E përbashkëta tjetër e komunave të mëdha është se pjesa dërmuese e tyre duhet të përmirësojnë cilësinë e kontrolleve të brendshme, sikurse edhe të punojnë në zbatimin e rekomandimeve të ndryshme që janë adresuar nga Auditori i jashtëm në vitet paraprake, për të eliminuar dobësitë e identifikuar në të gjitha fushat.

EC Ma Ndryshe vlerëson se lidershipi i komunave të mëdha të Kosovës duhet të lexoj me kujdes të gjeturat e Auditorit dhe të ndërmarrë hapa të duhura për adresimin e tyre, me qëllim të ofrimit të një qeverisjeje më të mirë në interes të publikut. Ndërkaq inkurajon edhe vazhdimin e veprimeve pozitive në fusha të caktuara në komunat që janë evidentuar nga Auditori.

Duke i marrë për bazë të gjeturat e Auditorit, EC Ma Ndryshe rekomandon, që:

- Komunat të reflektojnë seriozisht mbi të gjeturat e ZAP-it dhe të zbatojnë në tërësi të gjitha rekomandimet e Auditorit;
- Raporti i Auditimit të diskutohet në Kuvendet Komunale dhe anëtarët e KK-së të ushtrojnë presion më të madh te ekzekutivi komunal për zbatimin e rekomandimeve të ZAP-it;
- Të ndërmerren veprime serioze për përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit brenda komunave, në të gjitha fushat e identifikuara nga ZAP-i;
- Në ato komuna ku Auditori vit pas viti konstaton dobësi të theksuara, MF dhe MAPL të intervenojnë për zbatim të ligjit.

Projektin “Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale” EC Ma Ndryshe ka nisur që ta zbatoj nga maji i vitit 2015, falë përkrahjes së Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, i cili do të ketë shtrirje në shtatë komunat kryesore të Kosovës, Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj dhe Gjakovë. Projekti në fjalë ka për qëllim që ti asistoj komunat në identifikimin e mangësive kryesore sa i përket transparencës sikurse edhe të ofroj udhëzime për adresimin dhe tejkalimin e tyre. Indeksi i Transparencës paraqet edhe një përpjekje të strukturuar për të mbështetur komunat e Kosovës në përmbushjen e standardeve të qeverisjes së mirë, të përcaktuara me reformën e qeverisjes lokale dhe agjendën evropiane të Kosovës.

Me respekt,
Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren
Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti “Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale” përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.